



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 22.28.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË
PODUJEVËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, maj 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Podujevës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga, Luljeta Sylaj, Udhëheqës Ekipi dhe Anëtarët Syeda Oruqi dhe Ardita Salihu, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Zuke Zuka.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	27
5 Qeverisja e mirë.....	28
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	31
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	33
Shtojca III: Letër konfirmimi	40

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Podujevës, për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 01/11/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i komunës.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Komunës së Podujevës për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Si theksim të çështjes, duam të përmendim faktin se informatat e shpalosura në Pasqyrat Financiare Vjetore në lidhje me pasuritë dhe Llogaritë e Arkëtueshme nuk janë të sakta.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e Kryetarit të Komunës**

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e komunës. Ne kemi analizuar veprimtarinë e saj se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontroleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Podujevës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Sipas rregullores 02/2013, të gjitha pasuritë jo financiare, pas pranimit duhet të regjistrohen në regjistra kontabël pavarësisht a janë të paguara apo pjesërisht të paguara. Zyrtari i pasurisë nuk ka respektuar kërkesat e rregullores dhe ka regjistruar vetëm pasuritë për të cilat është realizuar pagesa (bazuar në dokumentet përkatëse të pagesave të kryera);
- Një numër i pronave që janë në shfrytëzim dhe në pronësi të komunës në vlerë prej 20,000€ nuk ishin përfshirë në regjistrin kontabël. Po ashtu "Objekti Mileniumi 2000" në pronësi të komunës, nuk figuronte në këtë regjistër;
- Inventari për objektin e ri komunal, nënshkruar si të pranuar në vlerë 52,384€, nuk është pranuar realisht dhe nuk është në përdorim; dhe
- Për vitin 2017, Llogaritë e arkëtueshme për tatimin në pronë ishin mbivlerësuar për 41,199€, si rezultat i një gabimi teknik i cili ende nuk është përmirësuar.

Shpalosjet e pasakta ishin për shkak të mungesës së qasjes adekuate për të menaxhuar pasuritë dhe shpenzimet konform rregullave të aplikueshme. Opinioni jonë nuk është modifikuar për këto çështje.

Çështjet kyçe të auditimit

Projekti për ndërtimin e ujësjellësit "Vrella" në bashkëfinancim me qytetarët¹, ka filluar qysh në vitin 2009 në vlerë 331,336€, i cili ende s'ka përfunduar. Qytetarët kishin participuar me vlerë prej 70,120€, e cila shumë është duke u bartur vit pas viti, si shkak i mos realizimit të projektit. Sipas komunës, një prej fshatrave ka krijuar pengesat për shfrytëzimin e burimit të ujit, derisa pagesat për punët e kryera në disa fshatra arrijnë vlerën 173,000€. Ne do të përcjellim këtë projekt me ndikim social, vonesa e të cilit prek mirëqenien e qytetarëve të cilët kanë participuar drejtpërdrejtë në zbatimin e projektit.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryetari i Komunës së Podujevës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të komunës.

¹ Fshatrat: Zakutë, Dobërdol, Metehi, Revuq, Pakashticë dhe Kërpimëh.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshin edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportojë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Kërkesat e ligjeve Organike për Qeverisje Lokale;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve;
- Raportet tremujore duke përfshirë këtu edhe pasqyrat nëntëmujore me kohë;
- Raportet dhe faturat e papaguara; dhe
- Planin e prokurimit dhe raportin për kontratat e nënshkruara publike.

Në kontekst të PFV-ve, këshillat që i kemi dhënë në Memorandumin e Auditimit ishin adresuar gjatë procesit të përgatitjes së tyre. Por sfidë edhe më tutje mbetet angazhimi i Zyrtarit Kryesor Financiar (ZKF).

Në PFV-të e dorëzuara në muajin janar 2018 ishin disa gabime, mirëpo komuna ka korrigjuar PFV-të e saj duke përmirësuar raportimin. Megjithatë, edhe në PFV-të e korrigjuara kanë mbetur disa gabime si:

- Te neni 18, Raporti për obligimet (faturat) e papaguara – ne vërejtëm se nuk ishin përfshirë të gjitha obligimet që i takonin komunës. Për me tepër edhe saldo fillestare e vitit 2017 nuk ishte e saktë²; dhe
- Shpalosjet te regjistri i pasurive kapitale dhe llogaritë e arkëtueshme nuk janë prezantuar drejtë (shih Theksimin e çështjes te opinionin e auditimit).

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në MF, mund të konsiderohet e saktë në të gjitha aspektet materiale.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Në lidhje me të gjeturat e lartcekura ne japim rekomandimin në vijim:

Rekomandimi 1 Kryetari duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprime specifike për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar gabimet në evidentimin e pasurive dhe për ta konfirmuar vlerësimin e saktë të obligimeve të papaguara.

Gjithashtu duhet të vendosen procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

² Referoju çështjes 16

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, Llogaritë e Arkëtueshme (LIA), pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Kontrollet mbi menaxhimin financiar janë të vendosura mirëpo ende kërkojnë të jenë efikase për kategori të veçanta.

Kontrollet mbi realizimin e të hyrave dhe investimeve kapitale duhet të shtohen me qëllim që komuna të realizojë ato në një përqindje më të lartë kundrejt mundësive të saj. Përveç kësaj nevojitet një përqendrim më i shtuar i komunës në parandalimin e rritjes së LIA-së dhe gjetjen e formave për inkasimin e tyre.

Vlen të theksohet se rreth 61% e buxhetit të investimeve kapitale ishte shpenzuar në tremujorin e fundit, derisa vetëm në dhjetor ishin shpenzuar 1,777,276€ apo 36% e totalit të shpenzimeve. Kjo paraqet një tregues se te projektet kapitale ka vonesa si tek proceset e prokurimit ashtu edhe në kryerjen e punëve. Kjo lë hapësirë për gabime të mundshme si gjatë kryerjes së punimeve ashtu edhe gjatë çertifikimit të pagesave.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ³	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	19,284,786	20,267,941	18,356,287	17,982,793	17,924,828
Grandi i Qeverisë -Buxheti	17,436,986	17,515,071	16,602,523	16,601,266	16,753,127
Të bartura nga viti paraprak ⁴	-	782,223	692,483	100,712	169,548
Të hyrat vetjake ⁵	1,847,800	1,847,800	1,013,791	1,009,326	898,769
Donacionet e brendshme	-	72,270	2,150	5,850	-
Donacionet e jashtme	-	50,577	45,340	265,639	103,384

³ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

⁴ Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁵ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 5% apo 983,155€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak në vlerë 782,222€ e cila bartje ishte aprovuar nga Kuvendi Komunal në mars të vitit 2017. Po ashtu, me vendim të Qeverisë, në dhjetor të vitit 2017 buxhetit i janë shtuar 93,070€ për mbulimin e disa projekteve⁶. Komuna kishte përfituar edhe nga donacionet e jashtme vlerën prej 50,577€ dhe nga donacionet e brendshme vlerën prej 72,270€. Ndërsa, në emër të kursimeve buxhetore nga kodi projektit 446277, buxheti është zvogëluar për 14,984€.

Për vitin auditues komuna ka shpenzuar 91% të buxhetit final, që konsiderohet një performancë e mirë e buxhetit, mirëpo krahasuar me vitin e kaluar ka një rënie të shpenzimeve për 3%, ngase në vitin 2016 ishte shpenzuar 94% e buxhetit. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	19,284,786	20,267,940	18,356,287	17,982,793	17,924,828
Pagat dhe Mëditjet	11,631,746	11,637,689	11,443,726	11,516,460	11,286,703
Mallrat dhe Shërbimet	1,287,178	1,308,688	1,045,464	1,218,728	992,577
Shërbimet komunale	324,500	324,500	320,572	324,499	322,522
Subvencionet dhe Transferet	568,883	758,295	646,681	427,702	555,714
Investimet Kapitale	5,472,479	6,238,768	4,899,844	4,495,404	4,767,312

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti për kategorinë e investime kapitale ishte rritur për vlerën e të hyrave vetanake të vitit të kaluar si dhe nga granti qeveritar. Pavarësisht rritjes së buxhetit, vetëm 78% e buxhetit të investimeve ishte shpenzuar. Performanca e ulët është si rezultat i kërkesave të vonuara nga njësitë kërkuese për iniciimin e procedurave të prokurimit, vonesat e realizimit të punëve nga kompanitë dhe moszgjidhja me kohë e çështjeve pronësore;
- Buxheti për paga dhe mëditje ishte rritur përmes buxhetit që është alokuar nga të hyrat vetanake për 5,943€, për të mbuluar deficitin e buxhetor të kësaj kategorie tek sektori i shëndetësisë primare;
- Me rishikim të buxhetit, kategoria e mallrave dhe shërbimeve kishte rritje të buxhetit në vlerë prej 21,510€. Vlera prej 11,858€⁸ ishte nga të hyrat vetanake. Po ashtu kësaj kategorie i janë shtuar edhe 9,652€ nga grantet e donatorëve të cilët kishin përkrahur projekte të ndryshme;

⁶ Asfaltimi i rrugës Katunishtë, 9,069,71€, Asfaltimi i disa rrugëve në Shtedim 16,663,82€, Asfaltimi i rrugës në Pakashticë e Epërme 33,537€, Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Batllavë 23,865€, dhe asfaltimi i rrugës në lagjet Kodralia, Kamerolli, Bashota dhe Potera në vlerë 9,936€.

⁷ Punimi, ndërtimi dhe vend-punishja e shtatores së Heroit "Ali Ajeti" në qytet. Punimi, ndërtimi dhe vendpunishja e Monumentit të tre Heronjëve të Kosovës "Zahir Pajaziti", "Hakif Zejnullahu" dhe "Ilir Konushfeci", në sheshin "Sheshi i Dëshmoreve.

⁸ Për mbulim e shpenzimeve të zyrës, ushqimit dhe shërbimeve kontraktuese tjera.

- Buxheti final për shpenzimet komunale nuk ka ndryshuar nga ai fillestar, dhe i njëjti ishte shpenzuar 98%, që tregon se kishte një planifikim të mirë në këtë kategori;
- Kategoria e subvencioneve dhe transfereve me vendimin e Kuvendit Komunal ishte rritur për 189,412€, e cila shumë ka rrjedhë nga të hyrat vetanake të vitit të kaluar. Qëllimi i shfrytëzimit ishte subvencionimi i bujqve, për bursa të studentëve dhe nxënësve, për aktiviteteve sociale, etj; dhe
- Gjatë vitit komuna gjithashtu ka pranuar grante nga donatorët vlerën 38,961€, të cilat ishin alokuar për të financuar kryesisht sektorin e bujqësisë. Ndërkohë që shpenzimi nga grantet (përfshirë ato të bartura nga viti kaluar) ishte 47,490€.

Çështja 2 - Nivel i ulët i realizimit të buxhetit të investimet kapitale

E gjetura	Shkalla aktuale e ekzekutimi të buxhetit për investime kapitale është sfida kryesore të cilën përballet komuna. Me gjithë faktin se kishte kërkuar buxhet shtesë, arsyetuar me faktin e mbulimit të shpenzimeve për disa projekte, përsëri vetëm 78% e buxhetit të kësaj kategorie është shpenzuar. Sipas komunës arsyet për nivelin e ulët të ekzekutimit lidhen me planifikimin jo të mirë të shpenzimeve, vonesat në inicimin dhe lidhjen e kontratave, si dhe ngeçjet në realizimin e projekteve. Nivel i ulët i shpenzimit ishte edhe tek mallrat dhe shërbimet në shkallë prej 79%.
Rreziku	Ekzekutimi i ulët i buxhetit e sidomos i investimeve kapitale do të rezultojë me shfrytëzim joefikas të burimeve në dispozicion. Për komunën mos-përmbushja e programit për investime kapitale do të rezultojë në realizimin e më pak projekteve si dhe në cilësinë e shërbimeve.
Rekomandimi 2	Kryetari, duhet të ndërmarrë një vlerësim sistematik të arsyeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit tek investimet kapitale dhe mallrat dhe shërbimet në 2017 si dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij për vitin 2018.

Çështja 3 – Pagesa direkt nga Thesari

E gjetura Pagesat në shumë 55,393€ për mallra dhe shërbime dhe 15,888€ për investime kapitale, kjo e fundit për projektin “Ndërtimi i shtëpive për raste sociale”, ishin ekzekutuar përmes nenit 39.2 dhe direkt nga Thesari. Punët ishin të përfunduara mirëpo nuk ishin paguar sipas procedurave të rregullta për shpenzimin e parave publike, si rezultat i planifikimit jo të mirë të nevojave dhe mjeteve për realizimin e tyre. Mjetet prej 15,888€ ishin tërhequr nga projekti (43183-Harta Zonale), derisa mjetet tjera ishin marrë nga subvencionet, shërbimet kontraktuese tjera, mirëmbajtje e automjeteve, si dhe nga kodi - furnizim zyre. Ekzekutimi i këtyre pagesave kishte shkaktuar shpenzime shtesë për 1,378€.

Për më tepër, komuna nuk mban një kopje të lëndës complete që ekzekutohet nga thesari, prandaj ne tërheqim vëmendjen që lëndët e tilla të jenë të kompletuara edhe nga vet komuna.

Rreziku Format e pagesës përmes vendimeve gjyqësore, rrezikojnë realizimin e projekteve të planifikuara kapitale apo realizimit të shërbimeve nga ku janë marrë mjetet për pagesë. Po ashtu pagesat e tilla mund të shkaktojnë dëmtim shtesë të buxhetit për shkak të shpenzimeve përmbare.

Rekomandimi 3 Kryetari, duhet të marrë masa me kohë në mënyrë që të shmang pagesat e tilla që dëmtojnë buxhetin e komunës dhe shkaktojnë devijime. Po ashtu, duhet siguruar që janë ndërmarrë veprimet e nevojshme në mënyrë që mangësitë e njëjta të mos përsëriten ngase kjo çështje është theksuar edhe në të kaluarën.

3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në 2017 ishin në vlerë 1,198,727€. Në këtë vlerë dominojnë të hyrat nga tatimi në pronë që përbën 31% të të hyrave të përgjithshme, pas tyre janë të hyrat nga lejet e ndërtimit, regjistrimi i automjeteve, participimet, taksat administrative etj. Po ashtu komuna këtë vit ka pranuar edhe të hyra nga gjobat nga trafiku dhe gjykatat në vlerë prej 71,111€ të cilat janë shpalosur në PFV.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Gjithsej të hyrat vetjake	1,847,800	1,847,800	1,198,727	1,481,270	1,180,319
Tatimi në pronë	460,000	460,000	373,613	581,729	393,158
Taksa komunale	1,387,800	1,387,800	825,114	899,541	787,161

Në vitin 2017 nga të hyrat vetjake ishin alokuar 1,941,205€⁹ nga të cilat ishin shpenzuar vetëm 88%, ndërsa 345,784€ janë bartur për tu shpenzuar në vitin 2018. Nga të hyrat vetanake mbulohen një pjesë e shpenzimeve por preferohet që të hyrat vetanake të destinohen për projekte kapitale.

Gjatë auditimit për mënyrën e menaxhimit të të hyrave në komunë ne kemi vërejtur disa mangësi si në vijim.

Çështja 4 - Mos efikasitet në mbledhjen e të hyrave

- E gjetura** Komuna e Podujevës ka shënuar trend negativ në realizimin e të hyrave. Vetëm 1,198,727€, apo 64% të planit kishte arritur të realizojë, apo 19% më pak se vitin e kaluar¹⁰. Ne kemi vërejtur se në lloje të ndryshme të të hyrave nuk ishin bërë planifikime adekuate dhe nuk ishin marrë masa të mjaftueshme për realizimin e të hyrave. Kjo vërehet tek ngecja në mbledhjen e të hyrave nga qiradhëniet, i cili plan ishte përmbushur vetëm 33%, si dhe realizimi i planit për ngarkesat e taksave komunale i cili ishte realizuar vetëm 57%.
- E gjetura** Planifikimi jo i mirë i të hyrave krahasuar me tendencat paraprake rrezikon ngecjen në realizimin e projekteve të planifikuara nga burimet vetjake dhe mos përmbushjen e objektivave të organizatës.
- Rekomandimi 4** Kryetari, duhet të analizoj arsyet e mos realizimit të hyrave dhe trendin e të hyrave gjatë viteve të fundit dhe në bazë të kësaj të bëjë një planifikim objektiv dhe të realizueshëm. Më tej, i njëjti plan duhet të pasohet me aktivitete dhe masa adekuate për zbatim dhe monitorim të planit.

⁹ 1,158,982€ nga të hyrat e vitit aktual dhe 782,222€ nga të hyrat e vitit të kaluar.

¹⁰ Në vitin 2015 kishte realizuar 74% të planit.

Çështja 5 – Ngecjet tek të hyrat nga qiraja

- E gjetura** Në një rast, komuna ka ngarkuar me qira mujore personin edhe pse kontrata i ishte ndërprerë, megjithëse i njëjti vazhdon ta shfrytëzon pronën komunale pa kontratë. Obligimet e tij ndaj komunës kishin arritur vlerën 12,538€. Ndërsa në një rast tjetër, edhe pse qiramarrësi ishte i obliguar të paguaj vlerën prej 330€ për qira mujore, ai nuk ka paguar asnjëherë duke u rritur borxhi i tij në 22,110€, si dhe të njëjtit nuk i është ndërprerë kontrata dhe vazhdon të shfrytëzoje të njëjtën pronë. Komuna aktualisht kishte shpërndarë njoftime tek qiramarrësit që nëse nuk paguanjë borxhin do të merren masa ndaj tyre.
- Rreziku** Menaxhimi i dobët i kontratave të qirave rezulton në rritjen e të arkëtueshmeve si dhe ka shkaktuar rritjen e papërgjegjshmërisë së qytetarëve të cilët shfrytëzojnë pronat publike në mënyrë të kundërligjshme.
- Rekomandimi 5** Kryetari, duhet të siguroj se asnjë pronë publike nuk do të lejohet të shfrytëzohet dhe keqpërdoret pa pagesën e qirave të parapara me kontratë. Duhet të gjenden forma që të merren masa të menjëhershme që detyrojnë obliguesit të respektojnë detyrimet kontraktuale.

Çështja 6 – Mungesa e përditësimit të të dhënave nga tatimi në pronë

- E gjetura** Komuna nuk ka arritur të përditësojë regjistrin e tatimpaguesve:
- Komuna në sistemin e tatimit në pronë ka të regjistruara 28,573 prona derisa në bazë të raportit për shpërndarjen e faturave tek tatimpaguesit del se janë vetëm 18,723 sosh. Sipas komunës dhe nga testimi i mostrave tona kemi vërejtur se në sistem ka të dhëna të dyfishuara dhe jo të plota të cilat bëjnë që të duket numër më i madh i tatimpaguesve; dhe
 - Komuna nuk kishte arritur të kryej verifikimin e 1/3 së pronave të paluajtshme siç kërkohet me ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme nr. 03/L-204 dhe UA në fuqi. Nga gjithsej 28,573 prona deri më tani komuna ka arrit të verifikoj vetëm rreth 2,598 sosh. Sipas zyrtarëve verifikimi i 1/3 së pronave është një gjë e pamundur për shkak të numrit të vogël të stafit.
- Rreziku** Mos përditësimi i të dhënave që lidhet edhe me verifikimin e 1/3 të pronave mund të rezultojë me mangësinë e informatave të plota të pronës së tatueshme aktuale, me ndikimin e mundshëm që të hyrat e vlerësuara për tatimin në pronë të ulen.
- Rekomandimi 6** Kryetari, duhet të analizoj arsyet pse kërkesat ligjore në këtë fushë nuk janë zbatuar dhe të ndërmerr veprime shtesë që të siguroj se në vitin vijues do të bëhet verifikimi i pronave komunale siç parashihet me ligj. Po ashtu të angazhohet që së bashku me Departamentin e Tatimit në Pronë t'i largojë nga regjistri të dhënat e pasakta.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar (payroll) që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike (MAP) dhe MF. Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me: kontrollin e pagesave, nënshkrimin e listave të pagave, verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve, azhurnimin e dosjeve të personelit si dhe rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me thesarin.

Për vitin 2017 buxheti për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 11,637,689€ me një shpenzim prej 11,443,726€, duke rezultuar kështu me një suficit në vlerë 193,963€. Kategoria e pagave është e mbuluar nga fondi i grantit qeveritar.

Testet tona kanë vënë në pah mangësitë si në vijim:

Çështja 7 - Kompensimi i pagave dhe buxheti i koeficienteve

E gjetura Për kategorinë paga dhe mëditje, ndonëse ka buxhet të mjaftueshëm, komuna nuk ka arritur të harmonizojë koeficientet e punonjësve që janë të lejuar me buxhet, me ata aktual. Kjo ka bërë që punonjësit të dëmtohen në pagë.

Në këtë aspekt, për 14 inspektorë janë të buxhetuara paga me koeficientë 7, ndërsa 13 prej tyre paguhen me koeficientë 6; tek shërbimet kadastrale pesë pozita janë të lejuara me koeficientë 7, derisa vetëm një prej tyre paguhet me këtë koeficientë.

Në lidhje me këtë, në vitin 2016, komuna kishte marrë një përgjigje nga MAP, sipas së cilës kërkesa e komunës për ngritje të këtyre koeficienteve nuk ka bazë ligjore sepse duhej pritur që të zbatohet vendimi i Qeverisë¹¹ për sistematizim. Që nga kjo periudhë komuna nuk ka ndërmarrë ndonjë hap tjetër.

Rreziku Kompensimi jo i drejtë i punonjësve sjellë demotivim të tyre duke rrezikuar të ofroj një shërbim jo cilësor ndaj qytetarëve. Përveç kësaj komuna mund të jetë subjekt i kontesteve gjyqësore apo dhe të përballet me uljen e reputacionit të saj.

Rekomandimi 7 Kryetari, duhet të sigurojë se Zyra e Burimeve Njerëzore dhe ajo e Financave kanë ndërmarrë hapat e duhur dhe në bashkëpunim me MAP-in të harmonizojnë në sistem të pagave koeficientët ashtu siç janë të lejuar me ligj, njëkohësisht të bëhet edhe azhurnimi i akt-emërimeve.

¹¹ Vendimi i Qeverisë së Kosovës nr. 04/89 datë 25.05.2016 për klasifikimin e vendeve të punës i cili mendohej të fillonte nga 01.09.2016.

3.4 Menaxhimi i personelit

Sipas Ligjit Nr.03/L-149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës; Ligjit të Punës Nr.03/L-212 dhe Ligjit mbi të drejtat dhe detyrime Nr.04/L-077 rregullohen çështjet të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin dhe organizimin e personelit. Çështjet e evidentuara që kanë të bëjnë me dobësitë në menaxhimin dhe organizimin e personelit i paraqesim në vijim:

Çështja 8 - Marrëveshjet për shërbime të veçanta

- E gjetura** Komuna për realizimin e shërbimeve të domosdoshme, kishte angazhuar 23 persona përmes Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta (MShV). Në 10 rastet e rishikuara kemi vërejtur se zyrtarët ishin angazhuar në kryerjen e punëve për periudhën më të gjatë se gjashtë muaj. Përveç tjerash dy prej tyre ishin duke kryer aktivitetet që nga viti 2010. Ky staf ishte angazhuar në pozita të ndryshme si konsulent, zyrtarë për bujqësi, përkthime, digjitalizim të rrugëve, roje, pastruese, etj.
- Rreziku** Mbulimi i pozitave me marrëveshje të përkohshme rezulton me performancë dhe monitorim të dobët të stafit dhe rritë pasigurinë nëse në pozitat e tilla është angazhuar stafi meritator.
- Rekomandimi 8** Kryetari, duhet të sigurojë se punonjësit me kontrata për shërbime të veçanta të angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike dhe angazhimet për këto shërbime nuk duhet të zgjasin më shumë se gjashtë muaj. Për të gjitha pozitat e rregullta të punës duhet të sigurohet se buxhetohen nga kategoria e pagave dhe mëditjeve si dhe paguhen nga sistemi i pagave.

Çështja 9 - Mos plotësimi i pozitës së udhëheqësit të prokurimit

E gjetura Sipas Rregullores 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, neni 4, për pozitën drejtuese në rast se nuk ka kandidatë nga nëpunësit ekzistues, atëherë zhvillohet procedura e hapur e rekrutimit.

Përkundër kësaj, pozita e udhëheqësit të prokurimit, kishte mbetur e lirë që nga janari i vitit 2017, nga kur ishte pensionuar nëpunësi dhe ende nuk ishte shpallur konkurs. Kryetari i Komunës, kishte autorizuar një zyrtar të prokurimit për nënshkrimin e kontratave deri në zgjedhjen e udhëheqësit të prokurimit. Përkundër kësaj në planin e personelit, plotësimi të kësaj pozite i ishte dhënë prioritet, mirëpo sipas tyre nuk po gjendet kandidat i cili përmbush kushtet e përcaktuara. Njëkohësisht, komuna kishte angazhuar si ekspert në fushën e prokurimit, ish menaxherin e prokurimit, me marrëveshje për shërbime të veçanta, fillimisht për gjashtë muaj dhe pas kësaj periudhe është vazhduar kontrata edhe për gjashtë muaj tjerë. Sipas ligjeve në fuqi këto kontrata nuk duhet të tejkalojnë periudhën gjashtë mujore.

Rreziku Mos plotësimi i pozitës së udhëheqësit të prokurimit, rrezikon që performanca dhe niveli i përgjegjësisë në fushën e prokurimit të jetë i ulët, e që mund të ketë ndikim në dështimin e objektivave të komunës. Kjo ka shkakuar edhe kosto shtese duke angazhuar ekspert të kësaj fushe dhe jo sipas kërkesave ligjore.

Rekomandimi 9 Kryetari, duhet të sigurojë se shpallja e konkursit për pozitën e menaxherit të prokurimit të bëhet sipas kërkesave ligjore, në mënyrë që kjo pozitë të mbulohet si pozitë e rregullt nga persona kompetentë.

3.5 Mallrat dhe shërbimet si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalit në vitin 2017 ishte 1,633,188€, kurse buxheti ishte realizuar 84%. Pjesa më e madhe e shpenzimeve në këtë kategori përfshijnë, derivatet dhe lëndët tjera për ngrohje, mirëmbajtje të objekteve, mirëmbajtje të rrugëve, servisim të veturave, furnizime mjekësore etj. Po ashtu, nga kjo kategori janë ekzekutuar pagesa direkte nga Thesari, bazuar në nenin 39.2 dhe 40 të LMFP-së.

Çështja 10 - Mangësi në procesin e pagesave

E gjetura Në tri raste me vlerë 40,744€ kemi vërejtur që pagesat e faturave nuk ishin ekzekutuar brenda 30 ditësh, por kishin zgjatur deri në gjashtë muaj vonesë derisa janë procesuar për tu ekzekutuar për pagesë.

Te projekti “Pajisje për mirëmbajtjen e shkollave”, me vlerë 5,753€, ishte caktuar komisioni prej tre anëtarëve për pranimin e mallit, derisa malli ishte pranuar vetëm nga dy anëtarë.

Rreziku Mos pagesa e faturave me kohë mund të ndikojë në ç'rregullimin e bilancit të pagesave dhe ekzekutimin e tyre përmes përmbaruesve, derisa mos pranimi i mallit nga personat e caktuar mund të ndikojë në pranimin e mallrave që nuk janë në pajtim me kushtet e kontraktuara.

Rekomandimi 10 Kryetari, duhet të iniciojë një rishikim të brendshëm për të përcaktuar pse kërkesat e rregullës financiare nuk janë adresuar në të gjitha rastet, dhe të përcaktojë masat/proceset e duhura për të siguruar që dështimet e ngjashme nuk do të ndodhin në të ardhmen.

3.6 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 758,295€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 646,681€. Ato kanë të bëjnë me subvencionimin e fermerëve, bursa te studentëve dhe nxënësve, si dhe mbështetje për aktivitete kulturore dhe sociale, etj.

Çështja 11 - Ndarja e subvencioneve dhe transfereve

E gjetura Te ftesa publike për përkrahjen e fermerëve me sistemin e ujitjes pikë-pikë, komuna kishte vendosur kriter që fermerët të cilët ishin përfitues të mëhershëm të subvencionit të mos përfitojnë edhe subvencionin e dytë. Ndërkohë që në rastin e testuar i njëjti person paraprakisht kishte fituar një projekte për serë si dhe ishte përfitues edhe i projektit për sistemin e ujitjes.

Rreziku Mos respektimi i kriterëve të vendosura nga vet komuna, mund të shpie në keq përdorim të qëllimit të subvencioneve, dhe njëkohësisht dëmton përfituesit e rinj potencial.

Rekomandimi 11 Kryetari, duhet t'i forcojë kontrollet mbi menaxhimin e subvencioneve dhe të sigurojë që subvencionet ndahen në përputhje me rregullat dhe kriteret e vendosura, në mënyrë që përfitues të jenë vetëm të merituarit.

3.7 Investimet kapitale

Për vitin 2017, buxheti final i investimeve kapitale ishte 6,238,768€ dhe shpenzimi 4,899,844€ apo 79%. Vitin e kaluar shkalla e realizimit ishte 85%, sidoqoftë krahasuar në shumë absolute, vitin e kaluar kishte projekte kapitale gjithsej në vlerë 4,495,404€, respektivisht rreth 9% më pak se në 2017.

Çështjet që janë identifikuar gjatë auditimit janë:

Çështja 12 - Realizimi i pagesave pa pranim të mallrave

E gjetura Për projektin “Inventarizimi i objektit të ri komunal” në vlerë 74,092€, komuna kishte kryer pagesën e parë në vlerë 61,124€ në dhjetor 2017. Ne kemi ekzaminuar në teren gjendjen e këtij inventari dhe konstatuam se menaxheri i kontratës kishte nënshkruar specifikat për pranim të inventarit edhe pse pjesa më e madhe e tij nuk gjendej në objektin e ri komunal. Sipas zyrtarëve, inventari nuk ishte pranuar në tërësi meqë në objektin e ri kishte pasur rrjedhje uji dhe inventari gjendej në mobilierinë e kontraktuar. Në lëndë nuk kishte ndonjë dokument që vërtetonin krijimin e kushteve të tilla, raportimin e gjendjes apo dokumente që vërtetonin se inventari gjendet tek operatori apo që pronësia i takon komunës. Vlera për inventarin që nuk ishte në objekt por për të cilin ishte kryer pagesa, ishte 52,384€.

Rreziku Kryerja e pagesave në mungesë të pranimit faktik të mallrave apo punëve bie ndesh me rregullat financiare për shpenzimin e parave publike dhe përbën rrezik të vazhdueshëm që komuna të humb paratë e dhëna. Gjithashtu, veprimet e tilla lënë hapësirë për dyshime se komuna përfshihet në marrëveshje verbale jologjore me Operatoret Ekonomik (OE) vetëm në mënyrë që pagesat të iu kryhen sa më parë operatorëve.

Rekomandimi 12 Kryetari, duhet të sigurojë se çdo organ mbikëqyrës, komision pranimi apo menaxher kontrate është përgjegjës për veprimet që ndërmerren me rastin e furnizimit të mallrave. Për rastin në fjalë, të ndërmerren masat që sa më parë të kryhen furnizimet dhe të krijohet një komision i veçantë i cili do të pranojë me saktësi inventarin e porositur.

Çështja 13 - Hyrje në kontrata pa mjete të buxhetuara

E gjetura Me rastin e nënshkrimit të disa kontratave, komuna kishte hyrë në obligime më të larta se sa që ishin të lejuara me buxhetin e vitit 2017. Gjatë procedurave, ishin nënshkruar formularë të disponueshmërisë së mjeteve përkundër që shumat nuk korrespondojnë me ato të lejuara me buxhet. Po ashtu edhe zotimet ishin më të ulëta se sa shumat e kontraktuar, si:

- Për projektin “Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Revuçë”, kontrata ishte nënshkruar në vlerë 91,463€ derisa zotimi ishte vetëm 35,000€; dhe
- Për projektin “Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Shtedim”, kontrata ishte nënshkruar në vlerë 131,663€ derisa të buxhetuara dhe të zotuar ishin vetëm 90,000€.

Rreziku Nënshkrimi i kontratave në vlerë më të lartë se ajo e buxhetuar rrezikon mos përmbushjen e obligimeve ndaj OE dhe mundësisë që këto pagesa të ekzekutohen direkt nga Thesari apo përmbaruesit, duke shkaktuar kosto shtesë dhe duke dëmtuar realizimin e projekteve tjera të planifikuara.

Rekomandimi 13 Kryetari, duhet të sigurojë se para nënshkrimit të kontratave të sigurohet se ekzistojnë fondet e mjaftueshme që e mbulojnë realizimin e tërësishëm të projektit për vitin përkatës, si dhe të siguroj se janë bërë zotimet e mjeteve sipas nevojave dhe rregullave të përcaktuara.

Çështja 14 – Mos ndarja e përgjegjësisë në mes të komisioneve

E gjetura Gjatë tenderimit përmes procedurës konkurs projektimi për "Shtatoren e heroit Ali Ajeti", komuna kishte caktuar një komision profesional për vlerësimin e projektit (ekzemplarit origjinal të shtatores). Por, i njëjti komision kishte vlerësuar edhe përshtatshmërinë e ofertuesit. Sipas udhëzuesit të prokurimit publik, tek konkurset e projektimit duhet të krijohen komisione të veçanta: për vlerësimin e përshtatshmërisë teknike të ofertuesit dhe përshtatshmërinë e projektit, ekzemplarit të shtatores.

Rreziku Mos ndarja e përgjegjësisë në komisione përkatëse, rrezikon që procedura për konkurs projektimi (ai për koncept projektin dhe ai për dokumentacion të kandidatit) të mos vlerësohen drejt dhe në mënyrë të pavarur në mungesë të dy komisioneve të ndara.

Rekomandimi 14 Kryetari, duhet të sigurojë se zyra e prokurimit ndjekë me përpikëri kërkesat që dalin nga udhëzuesi i prokurimit me rastin e tenderimeve të konkurseve projektuese.

Çështja 15 - Ndarja e tenderëve dhe përdorimi i procedurave minimale

E gjetura Nga raporti i kontratave të nënshkruara kemi vërejtur se:

- Nga 209 kontrata të nënshkruara përmes procedurave tenderuese, 68 prej tyre (32%) ishin bërë sipas procedurës minimale si dhe 41 (20%) ishin me kuotim çmimesh. Kjo përbën një raport relativisht të lartë të përdorimit të këtyre procedurave, dhe paraqet një dukuri jo të favorshme kur marrim parasysh madhësinë e kësaj komune si dhe humbje financiare për shkak se në rastet e tilla çmimet e ofertuesve mund të jenë më të larta;
- Më tej, sipas LPP-së, Autoriteti nuk do të ndajë kërkesën për prokurim për një sasi të caktuar të produkteve me qëllim të zvogëlimit të vlerës së kontratës për furnizim nën kufirin e caktuar. Gjatë vitit 2017, ishin zhvilluar 23 procedura të prokurimit për hartimin e projekteve të ndryshme zbatuese sipas procedurës së vlerës minimale apo kuotim që në total përbëjnë vlerën

mbi 106,996€, kjo në vend se të shkonin me një tender prokurimi/ procedura të hapura. Për këtë çështje, ne nuk kemi marrë ndonjë përgjigje nga komuna (departamenti i prokurimit).

Rreziku Përsëritja e blerjeve të njëjta gjatë periudhave të përafërta kohore dhe përdorimi i lartë i procedurave të kufizuara, bën që komuna t'i shmanget procedurave të hapura, si pasojë shërbimet në këtë mënyrë mund të ofrohen me çmime më të larta, kualitet më të ulët dhe të mos arrihet vlera për paranë e shpenzuar. Edhe pse kuotimi tashmë është procedurë e hapur, afatet ligjore dhe vlerat janë më të kufizuara se sa tek procedura e hapur, prandaj rrezikon konkurrencën e drejtë.

Rekomandimi 15 Kryetari, duhet të sigurojë se kërkesat e prokurimit duhet të përmbliidhen qartë dhe me kohë nga njësitë kërkuese për të eliminuar nevojën për procedura të shpeshta dhe përdorimin e procedurave minimale dhe kuotimin. Kjo duhet të bëhet duke planifikuar me kohë dhe duke u fokusuar në një proces efektiv të prokurimit që siguron vlerën për paranë e shpenzuar.

3.8 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja 16 – Vonesat në realizimin e projekteve kapitale

E gjetura Në disa projekte kemi vërejtur vonesa në realizimin e punëve:

- Në kontratat “Asfaltimi i disa rrugëve në lagjen Bajgora” dhe “Asfaltimi i rrugës në fshatin Obranqë” të nënshkruara në fund të vitit 2016, është paraparë që projektet të kryhet brenda 50 dhe 40 ditëve kalendarike. Këto projekte janë përfunduar në korrik 2017, pra me shtatë muaj vonesë. Përmes librave ndërtimorë vërejtëm se kryerja e punëve nga OE është evidentuar në ditë pune. Sipas zyrtarëve komunal, vonesat ishin shkaktuar për disa arsye: nga janari deri në mars nuk është punuar me arsyetimin se është sezoni dimëror, kishte ditë të paarsyetuara nga menaxheri i projektit si dhe shkaku i çështjeve të pazgjidhura pronësore.
- Projekti për “Ndërtimin e Serave” kontratë e nënshkruar në maj të vitit 2017, ishte paraparë të përfundojë brenda 60 ditësh derisa as gjatë kohës sa ne ishim në teren (në muajin prill 2018) kjo nuk kishte përfunduar. OE ka filluar punët me vonesë rreth një muaj, me arsyetimin e mungesës së lëndës së parë e cila nuk prodhohet në Kosovë. Po ashtu arsyetohen me ndërprerje të punëve nga ana e OE për shkak të mos pagesës së situacioneve nga ana e komunës dhe për shkak të kushteve klimatike.

Përkundër vonesave në rastet e lartcekura, komuna nuk kishte aplikuar ndëshkimet e parapara me kontratë.

Rreziku Mosrealizimi i projekteve sipas planit dinamik dhe kushteve të kontraktuara, monitorimi jo i mjaftueshëm dhe fillimi i punimeve pa zgjidhur problemet pronësore, ndikon në tej zgjatjen e realizimit të projekteve, dështimin e aplikimit të penaleve ndaj OE për vonesa të paarsyetuara, po ashtu edhe në mosarritjen e objektivave të planifikuara dhe vlerës më të mirë për paranë e shpenzuar.

Rekomandimi 16 Kryetari, duhet të ndërmerret masat për forcimin e kontrolleve lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të projekteve sipas planit dinamik dhe kushteve të kontratës, raportimin dhe aplikimin e ndëshkimeve në rast të vonesave të paarsyetuara, si dhe zgjidhjen e çështjeve pronësore para fillimit të punimeve.

3.9 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Një menaxhim i mirë i pasurive kërkon që komuna të ketë një pamje të plotësisë së pasurive, procedura të kontrollit dhe menaxhimit të tyre dhe të azhurnojë vazhdimisht ndryshimet në regjistrat e saj. Komuna ka pasur progres sa i përket regjistrimit të pasurisë së trashëguar, megjithatë, mbetet ende punë për tu bërë dhe koordinim më i theksuar mes disa drejtorive. Vlera e pasurive kapitale në PFV në fund të vitit 2017 është 79,684,072€.

Çështja 17 - Dobësi në menaxhimin dhe raportimin e pasurisë

E gjetura Këshilltarët e Kuvendit Komunal për legjislaturën 2014-2017 kishin pranuar laptop me qëllim të ushtrimit të funksionit të tyre. Sipas vendimit të Kuvendit, datë 15/01/2014, të njëjtët pas kalimit të mandatit të tyre duhet t'i dorëzohen komunës. Përkundër kësaj, gjithsej 24 këshilltarë komunal nuk i kishin kthyer laptopët, edhe pse e kishin përfunduar mandatin dhe nuk ushtronin më këtë detyrë as në legjislaturën aktuale. Vlera e mbetur e këtyre laptopëve, pas zhvlerësimit të rregullt ishte 4,444€. Për më tepër, moduli E-pasuria nuk përdoret fare nga sektori i shëndetësisë.

Rreziku Mungesa e informatave të sakta rreth pasurisë dhe mos përdorimit gjithëpërfshirës i sistemi e-pasuria, pamundëson një menaxhim dhe kontroll efektiv mbi pasuritë. Menaxhimi jo adekuat i përdorimit të pasurisë, mundëson keqpërdorimin apo humbjen e pasurisë.

Rekomandimi 17 Kryetari, duhet të sigurojë se të gjitha drejtoritë bashkëpunojnë efektivisht me zyrtarin e pasurive në mënyrë që të ketë një regjistr të plotë të pasurive si dhe në përdorimin e sistemit e-pasuria. Në anën tjetër, të merren veprime ligjore për kthimin e laptopëve në komunë dhe rastet e tilla të mos përsëriten në të ardhmen.

3.10 Të arkëtueshmet

Të arkëtueshmet përbëhen kryesisht nga: tatimi në pronë, taksa në firmë, hapësirat publike dhe qiraja komunale. Komuna, nuk ka arritur t'i arkëtojë të gjitha borxhet për të cilat ka ofruar shërbime, në mungesë të politikave adekuate dhe masave konkrete. Vlera e të arkëtueshmeve në fund të vitit 2017 kishte arritur në 7,270,304€.

Çështja 18 - Mungesa e masave konkrete për mbledhjen e borxheve

E gjetura

Në menaxhimin e të arkëtueshmeve kemi identifikuar mangësitë si në vijim:

- Komuna nuk ka të vendosura procedura të brendshme të shkruara dhe një formë për raportimin, regjistrimin dhe inkasimin me kohë të të gjitha LIA. Komuna mban dy baza të ndryshme të regjistrimeve: për qiradhënie dhe taksa në firmë atë në Excel dhe në Access, gjë që krijon dyfishim të punës dhe mundësi gabimi në gjenerimin e shumës së LIA;
- Prej mostrave të testuara të LIA nga tatimi në pronë, kemi konstatuar vonesa të konsiderueshme të inkasimit të të arkëtueshmeve, të cilat figuronin që nga viti 2002. Prej tyre 10 raste kishin të bënin me LIA, të cilat rrjedhin nga objektet që janë nën menaxhim të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me vlerë prej 47,096€. Po ashtu kishte raste kur qytetarët nuk kanë paguar asnjëherë tatimin, derisa në këtë aspekt, komuna nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim;
- Nga 4,169 biznese, të arkëtueshmet nga taksat në firmë kanë arritur vlerën prej 3,776,811€, dhe të njëjtat ishin rritur për 158,975€ krahasuar me vitin e kaluar. Në vitin 2017 obligimit iu kishin përgjigjur vetëm 200 biznese. Sipas komunës këtë vit, është planifikuar që kjo çështje do të trajtohet edhe përmes përmbaruesve në mënyrë që të inkasojë këto mjete; dhe
- Nga pronat e dhëna me qira, nga 225 qiramarrës, 183 prej tyre nuk kanë kryer asnjë pagesë gjatë vitit 2017, përkundër obligimeve kontraktuale.

Rreziku

Niveli i lartë i të arkëtueshmeve dhe jo efikasiteti në mbledhjen e tyre mbeten sfidë edhe për periudhën e ardhshme. Mos inkasimi i të arkëtueshmeve rrezikon që ato të bëhen të pa mbledhshme duke krijuar një rast precedent për borxhlinjtë e tjerë të cilët mund të ndjehen të trajtuar në mënyrë jo të barabartë dhe që rezulton në një humbje të drejtpërdrejtë financiare për komunën.

Rekomandimi 18

Kryetari, duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve. Po ashtu, duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.

3.11 Obligimet e papaguara

Komuna ka deklaruar obligime ndaj furnitorëve vlerën prej 150,388€, shumë kjo më e ulët për 28% krahasuar me vitin 2016. Derisa në lidhje me pretendimet e palëve tjera ndaj komunës, në bazë të kontesteve aktuale gjyqësore, komuna ka listuar gjithsej 12 raste të mundshme me një shumë të vlerësuar prej 76,830€.

Komuna zbaton një proces relativisht të rregullt të raportimit të obligimeve. Drejtoritë në përgjithësi janë të vetëdijshme për kërkesat e rregullores për raportim të faturave të papaguara si dhe zyrtari përgjegjës raporton me kohë në Thesar në lidhje me këtë. Megjithatë, në vijim kemi evidentuar të gjeturat:

Çështja 19 - Evidentimi dhe raportimi i obligimeve

E gjetura	<p>Testimet tona kanë identifikuar disa mangësi, të cilat ndikojnë që obligimet e paraqitura në PVF të mbivlerësohen/nënvlerësohen për një shumë simbolike, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Saldo fillestare e obligimeve nuk ishte e saktë. Gjatë vitit 2017, janë paguar gjithsej 242,263€ për faturat e viteve paraprake derisa në PFV janë deklaruar vetëm 210,161€ me të përfunduar viti fiskal 2016 si fatura të papaguara. Kjo nënkupton që të paktën për shumën 32,103€ obligimet e vitit 2016 janë nën deklaruar; dhe • Komuna për vitin 2017 nuk i kishte deklaruar tri shuma obligimesh ndaj furnitorëve për gjithsej 1,019€ të cilat kishin të bëjnë me bartje nxënësish dhe publikim të reklamave. Faturat datonin që nga shtatori 2017 dhe ishin paguar në janar 2018, si rrjedhojë obligimet janë nënvlerësuar për këtë shumë.
Rreziku	<p>Mos prezantimi i plotë i obligimeve ndikon që menaxhmenti të mos ketë një pasqyrë të qartë të obligimeve për çdo muaj dhe rritë rrezikun që planet e ardhshme të shpenzimeve të mos arrihen për shkak të nevojës për t'i paguar obligimet e paraprake.</p>
Rekomandimi 19	<p>Kryetari, duhet të sigurojë se është vendosur një sistem efikas ku faturat pranohen dhe raportohen saktë si për MF ashtu edhe për menaxhmentin. Po ashtu, në raportimet mujore duhet të përcjellët kronologjia e faturave të papaguara në mënyrë që faturat e papaguara të raportohen deri sa të paguhen dhe që menaxhmenti dhe Thesari të kenë informacionin e saktë për obligimet e mbetura.</p>

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2016 të Komunës së Podujevës ka rezultuar në 17 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna. Raporti i AP-së, ishte renditur si pikë për diskutim mirëpo nuk është diskutuar.

Nga rekomandimet e dhëna për vitin 2016, tri rekomandime janë zbatuar; gjashtë ishin në proces dhe tetë nuk janë adresuar ende. Nga viti 2015 ishin bartur 11 rekomandime tre të pa zbatuara dhe tetë të tjera ishin në zbatim e sipër. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 20 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

E gjetura Komuna, ka bërë progres të kufizuar në adresimin e rekomandimeve pasi që pak nga rekomandimet e vitit të kaluar janë zbatuar plotësisht, por që shumica nuk janë adresuar, disa pjesërisht ose nuk janë zbatuar fare. Komuna, nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP-së. Për më tepër Planin e Veprimit për rekomandimet dhe progresin e tyre, nuk ka arritur ta diskutojë në Asamblenë Komunale.

Rekomandimet e pa zbatuara si ai për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit, regjistrat e pasurive jo të plotë, mungesa e regjistrat të rreziqeve, performanca jo e mirë e NjAB-së, mos kryerja e obligimeve nga shfrytëzuesit e pronave të komunës (qiramarrësit) dhe taksa e biznesit, dobësitë në raportimin e obligimeve, marrëveshjet për shërbime të veçanta, mos verifikimi i 1/3 të pronave komunale, janë të gjetura të përsëritura në vite.

Rreziku Përmirësimet e kërkuara të proceseve operacionale dhe të tjera mund të mos zbatohen duke rezultuar në mos efikasitet të vazhdueshëm përderisa rekomandimet e dhëna nuk adresohen.

Rekomandimi 20 Kryetari, duhet të sigurojë që plani i veprimit, rishikohet duke analizuar shkaqet e rekomandimeve të pazbatuara, dhe të përcaktojë një afat të ri kohor për adresimin e rekomandimeve me anëtarët e stafit llogaridhënës, me fokus fillestar në fushat e një rëndësie më të madhe. Zbatimi i këtij plani duhet të monitorohet në vazhdimësi.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Në lidhje me qeverisjen e mirë vlerësojmë progresin që ka bërë komuna në lidhje me përpilimin e listës së rreziqeve për vitin 2018 dhe raportimet e rregullta financiare. Megjithatë, ekzistojnë disa mangësi sa i përket qeverisjes brenda komunës, veçanërisht në lidhje me mos zbatimin e plotë të rekomandimeve nga viti paraprak, realizimin e buxhetit dhe kontratat e nënshkruara, dhe iniciativa modeste për mbledhjen e të hyrave.

Sipas Ligjit për planifikimin hapësinor planifikimi i nivelit lokal bëhet përmes tri dokumenteve: Plani Zhvillimor Komunal; Harta Zonale e Komunës; dhe plani Rregullues të Hollësishme.

Komuna gjatë vitit 2017 kishte Planin Zhvillimor Komunal 2016-2025 i njëjti kishte të llogaritur koston për zbatimin e tij dhe afati për arritje të objektivave. Vlerësimi i kësaj strategjie ishte bërë vetëm në mënyrë joformale. Po ashtu, komuna ka edhe planin Zhvillimor Urban 2012-2022.

Aktualisht komuna ka bërë përgatitjet për hartimin e hartës zonale si dokument fillestar për krijimin e strategjisë, pas së cilës do të krijohet Plani i ri Zhvillimor Komunal. Po ashtu, në këtë fazë komuna ka hartuar planin rregullues urban "Zona Qendër", ku janë përcaktuar përgjegjësit dhe buxheti i nevojshëm për të.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me dy anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe një auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

Çështja 21 - Funkcionimi i NjAB-së

E gjetura

Ekzistojnë disa mangësi në lidhje me operacionet aktuale të NjAB-së, si:

- NjAB kishte arritur të finalizojë pesë¹² raporte aq sa edhe kishte planifikuar mirëpo asnjë nga këto raporte nuk përfshinte auditimin e periudhës aktuale; dhe
- NjAB, kishte dhënë gjithsej 18 rekomandime se si menaxhmenti të përmirësoj funksionimin e kontrollit të brendshëm, mirëpo njësitë që kanë qenë subjekt i auditimit nuk kanë përgatitur plane veprimi për adresimin e rekomandimeve.

Këto rezultate tregojnë jo gatishmëri në njohjen dhe maksimizimin e përfitimit të auditimit të brendshëm ose për të kërkuar siguri për funksionimin efektiv të kontrolleve të brendshme.

Rreziku

Ndjekja e ngjarjeve nga auditimi pasi ato të kenë ndodhur nuk i shton vlerë përmirësimit të gjendjes dhe parandalimit të gabimeve që mund të rrjedhin nga komuna. Derisa mos zbatimi i rekomandimeve të AB-së, ndikon që niveli i kontrolleve të brendshme të mos përmirësohet dhe rrit rrezikun që gabimet dhe mangësitë e njëjta të vazhdojnë të përsëriten, duke rezultuar në jo efikasitet operativ dhe humbje financiare.

Rekomandimi 21

Kryetari, duhet të ndërmarr veprime konkrete për përpilimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të NjAB-së dhe të marrë të gjitha veprimet ndaj njësisve administrative që u adresohen rekomandimet, që të kenë një përkushtim maksimal në marrjen e masave përmirësuese në fushat ku dobësitë janë identifikuar.

¹² Raportet për: Menaxhimin e të hyrave dhe shpenzimeve 2016, Rishikimi i proceseve të subvencioneve 2016, Procesi i Prokurimit 2016 dhe Menaxhimi i pasurisë dhe inventarit 2016 dhe Rishikimi i proceseve të donacioneve për vitin 2016.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara kanë nevojë për forcim në mënyrë që të mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 22 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

E gjetura Si pasojë e kontrolleve jo të mira menaxheriale, shuma të konsiderueshme të buxhetit për investime kapitale nuk janë shpenzuar dhe numër i madh i kontratave të prokurimit ishin lidhur në tremujorin e fundit të vitit. Po ashtu menaxhimi i LLA-së nuk ishte në nivelin e duhur. Menaxhmenti duhet të bëjë analiza të rregullta për ecuritë buxhetore, të rishqyrton planin e prokurimit si dhe arkëtimin e të hyrave.

Në anën tjetër, komuna për vitin 2017 nuk ka pasur regjistër të rreziqeve të hartuar sipas kërkesave të MFK-së, si dhe nuk ka strategji për menaxhimin e rrezikut, dhe nuk ka përgatitur ndonjë raport për menaxhimin e tyre.

Rreziku Kërkesat jo të forta të llogaridhënies dhe raportimi financiar duhet të forcohen për të ndikuar në efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë.

Rekomandimi 22 Kryetari, duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj strategjinë për menaxhimin e rrezikut me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontrolle kërcënimet e ekspozuara.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
2.3 Zbatimi i rekomandimeve të vitit paraprak	Kryetari duhet të forcoj masat e kontrollit dhe të përgjegjësisë ndaj personave të ngarkuar për adresimin të plotë rekomandimeve që veprimet e parashikuara me plan veprimi të zbatohen, në veçanti në fushat e identifikuar me shkallë të lartë rreziku dhe brenda afateve të përcaktuara.		Në proces, në 2017 ishin zbatuar edhe dy rekomandime të 2015.	
2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit	Kryetari duhet të siguroj se proceset e qeverisjes pasohen nga planet strategjike, menaxhimi i rrezikut dhe zbatimi i procedurave për matjen e rezultateve kundrejt objektivave. Gjithashtu, raportimi dhe komunikimi do të përmirësojnë aftësinë e menaxhmentit për të reaguar me kohë ndaj sfidave eventuale.		Është hartuar strategjia 2016-2018, mirëpo ende ka mangësi.	
2.5 Moszbatimi i kërkesave për Menaxhimin e rrezikut	Kryetari duhet të siguroj se do krijohen procedura formale për menaxhimin e rrezikut për organizatën, në mënyrë të përcaktoj dhe ndërmer veprimet e nevojshme nëse ato ndodhin, si dhe t'i monitoroj në mënyrë sistematike. Hapi i parë në këtë drejtim është hartimi i regjistrit të rreziqeve.	Po		
2.5.2 Dobësi në Kontrollat Menaxheriale	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme.			Nuk janë marrë masa.

2.6 Funksonimi i NJAB-it dhe komitetit të auditimit	Kryetari duhet të diskutoj një plan veprimi me nivelet tjera menaxhuese dhe të përcaktoj stafin përgjegjës dhe afatet për adresimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm. Një proces monitorimi mbi progresin, gjithashtu duhet të vendoset. Në identifikimin e çështjeve për trajtim, NJAB duhet të fokusohet më shumë në aktivitetet e vitit aktual, me prioritet në fushat ku rreziku vlerësohet i nivelit të lartë. Procesi i auditimit duhet të zhvillohet në pajtim me standardet dhe të jetë mirë i dokumentuar.			Nuk janë marrë masa.
3.3 Realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të monitorojë në mënyrë sistematike performancën buxhetore, si të hyrat, ashtu edhe shpenzimet brenda kategorive ekonomike dhe të identifikojë dhe adresojë me kohë barrierat për ekzekutimin maksimal të buxhetit.			Nuk janë marrë masa.
3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Kryetari duhet të siguroj se kontratat për shërbime të veçanta të përdoren për qëllime specifike aty ku me të vërtet ka mungesë të kuadrit si dhe kohëzgjatja e tyre mos të jetë mbi 6 muaj siç e përcakton ligji. Ne sugjerojmë që praktikatat e tilla të mos përsëriten.			Nuk janë marrë masa.
3.6 Të Hyrat vetjake	Kryetari duhet të siguroj një rishikim të sistemeve ekzistuese për të konfirmuar nëse mekanizmat që ka vendosur për mbledhjen e të hyrave mund të funksionojnë në mënyrë efektive, dhe se veprime shtesë janë ndërmarr që të siguroj se tatimet mblidhen në nivelet e parashikuara. Verifikimi i pronave komunale duhet të bëhet siç parasheh ligji në mënyrë që në bazën e të dhënave të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale tek pronat, të vlefshme për bazën e tatueshme.			Nuk janë marrë masa.

3.6 Të Hyrat vetjake	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se asnjë pronë publike nuk do të lejohet të shfrytëzohet dhe keqpërdoret pa pagesën e qirave të parapara me kontratë. Ne rekomandojmë që të merren masa të menjëhershme dhe të shqyrtohet në mënyrë kritike lista e debitorëve dhe arsyet pse ekziston kjo gjendje. Veprimet e duhura të merren sa më parë për të parandaluar vazhdimin e praktikave të tilla.			Nuk janë marrë masa.
3.6 Të Hyrat vetjake	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se do merren masa të shpejta për vendosjen e mekanizmave dhe kontrolleve të duhura për t'i mbledhur borxhet e prapambetura. Drejtoria e financave, gjithashtu duhet të forcoj kontrollet që këto taksa t'i inkasoj me kohë dhe të jetë më e vendosur në adresimin e këtij problemi.			Nuk janë marrë masa.
3.7 Pasuritë dhe detyrimet	Kryetari duhet të siguroj hartimin e një udhëzuesi të brendshëm për menaxhim të pasurive ku qartësohen rolet dhe detyrat e zyrtarëve të caktuar të cilët duhet të kontribuojnë në përgatitjen e të dhënave për pasurinë që duhet regjistruar, dhe më pas, të gjitha pasuritë të prezantohen drejt në PVF.			Nuk janë marrë masa.
3.7.2 Trajtimi i borxheve	Kryetari duhet të siguroj se të gjitha faturat do pranohen nga zyra pritëse (arkiva), të protokolohehen, dhe të distribuohen në Drejtoritë përkatëse në mënyrë që të ketë një raportim të drejt dhe evidenca të plota mbi detyrimet e Komunës.		Faturat protokolohehen, por jo të gjitha, si dhe ende ka mangësi në paraqitjen e saktë të obligimeve.	

Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2.Pasqyrat Financiare	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes së opinionit të auditimit. Regjistrimi i pasurive kapitale duhet të azhurnohet dhe të gjithë zërat që nuk përmbushin kriteret e pasurisë, duhet të largohen nga regjistrat. Kryetari duhet të siguroj se gjendet një zgjidhje e përshtatshme për plotësimin e pozitës së ZKF-së. Gjithashtu, para se pasqyrat të dërgohen në MF, ato duhet t'i nënshtrohen një rishikimi gjithëpërfshirës në lidhje me përmbajtjen dhe saktësinë e tyre, me theks të veçantë tek shpalosjet e ndryshimeve buxhetore dhe llogaritë e arkëtueshme.		Në proces, këtë vit pasqyrat nuk përmbajnë gabime materiale.	
2.1 Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari duhet të shqyrtoj arsyet pse një numër rekomandimesh nga viti i kaluar nuk janë zbatuar, si dhe të siguroj që plani i veprimit i përgatitur pas marrjes së këtij raporti, do të inkorporoj të gjitha rekomandimet e dhëna dhe do të përcaktoj saktë afatet kohore, masat dhe personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve. Gjithashtu, kryetari duhet të zbatoj masa përgjegjësie ndaj personave të ngarkuar për zbatimin e masave përmirësuese të proceseve, për çështjet e ngritura nga auditimi.		Disa nga rekomandimet janë adresuar mirëpo plani i veprimit nuk është diskutuar në Kuvend Komunal.	
2.2 Pyetësi i vetëvlerësimit	Kryetari duhet të siguroj se është rishikuar plotësimi i listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe është bërë në mënyrë proaktive adresimi i fushave me dobësitë e identifikuara nga pyetësi. Si një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës, nevojitet edhe përfshirja e auditimit të brendshëm.	Po		

2.3.2 Raportimi	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të siguroj se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme			Nuk janë marrë masa.
2.4 Sistemi i NjAB	Kryetari duhet të siguroj që NJAB të fokusohet më shumë në aktivitetet e vitit aktual, me prioritet në fushat ku rreziku vlerësohet i nivelit të lartë. Po ashtu, duhet të ndërmarr veprime konkrete për përpilimin e planit të veprimit për rekomandimet e AB dhe të kërkoj nga bartësit përgjegjës të cilëve u janë adresuar rekomandimet që edhe formalisht të raportojnë mbi zbatimin e atyre rekomandimeve. KA të nxjerr konkluzione të qarta për menaxhmentin lidhur me implementimin e rekomandimeve të dhënë nga AB.			Nuk janë marrë masa.
3.1 Realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të monitoroj në mënyrë sistematike performancën buxhetore, të ndërmarrë një vlerësim sistematik të buxhetit për investime kapitale, si dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij në 2017.			Nuk janë marrë masa.
3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të rishikoj rregulloren aktuale, në mënyrë që të ketë bazë ligjore dhe ta përshtat me nevojat konkrete. Po ashtu, të rishikoj tarifën e aplikuar për protokolim/pranim të faturave, meqë në këtë rast komuna nuk ofron shërbim për operatorin. Gjithashtu, të krijohet një formë raportimi e përshtatshme për monitorim për të gjitha zyrat e gjendjes civile.	Po		
3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të bëjë një rishikim të kontratave për të cilët qiramarrësit nuk i përmbahen kushteve kontraktuese dhe të merr masat e duhura për inkasim apo shkëputje të kontratës për qiramarrësit.			Nuk janë marrë masa.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të siguroj që akt emërimet e shërbyesve civil përmbajnë të dhënat e nevojshme siç është përcaktuar me rregullore, si dhe ato të karrierës bëhen me afat të pa caktuar, të bëhen përshtatjet në buxhet për kompensimin e stafit sipas kërkesave ligjore dhe me rastin e rekrutimit, si dhe të siguroj se aplikacionet janë trajtuar drejtë duke u bazuar në kriteret përkatës.		Në proces, disa nga stafi kanë dalë në pension dhe do të bëhen rekrutime të reja.	
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet	Kryetari duhet t'i rishikoj nevojat reale për angazhim të punëtorëve me kontrata për shërbime të veçanta. Nevoja për staf shtesë për pozitat e karrierës duhet të analizohet dhe nëse rritja e numrit të stafit është e domosdoshme, kjo të inkorporohet edhe në planifikimet buxhetore. Barrierat eventuale lidhur me rritjen e stafit, duhet të diskutohen edhe me Ministrinë e Financave dhe akterët tjerë.			Nuk janë marrë masa.
3.4.1 Subvencionet dhe Transferet	Kryetari duhet të siguroj një rishikim i rregullores së brendshme për subvencione, në mënyrë që një projekt-rregullore me përmirësimet e nevojshme t'i paraqitet kuvendit për ndryshime.		Është rishikuar rregullorja dhe pritet të dalë në Kuvend për aprovim.	
3.1.5 Investimet Kapitale	Kryetari duhet të siguroj se vendimet për komisione të caktohen sipas ligjit të prokurimit publik, udhëzuesit operativ të prokurimit publik dhe rregullores për menaxhimin e pasurisë. Vendimet të bëhen nga ZKA e jo nga menaxheri i prokurimit. Urdhërblerja duhet të bëhet pas zgjedhjes së ofertuesit me të cilin është nënshkruar kontrata. Të siguroj që para fillimit të secilës procedurë të prokurimit për projekte kapitale është bërë hartimi detal i projektit.	Po		
3.1.5 Investimet Kapitale	Kryetari duhet të rishikoj shkaqet që sjellin deri te pagesat direkte, me qëllim që të evitohen parregullsitë gjatë procesimit të pagesave.			Nuk janë marrë masa.

3.2.1 Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj një regjistër të saktë të pasurive, që zyrtari i pasurisë para se të bëjë regjistrimet e duhura, të sigurohet se plotësohen kriteret sipas rregullores për regjistrim në pasuri, si dhe të sigurohet funksionalizimi i sistemit e-pasuria në gjithë komunën. Komisioni për inventarizim të siguroj një raport përmbledhës për rezultatet e inventarizimit.		Pasuritë me disa vërejtje kanë filluar të regjistrohen të tëra.	
3.2.2 Të arkëtueshmet	Kryetari duhet të siguroj se asnjë pronë publike nuk do të lejohet të shfrytëzohet pa pagesën e qirave. Duhet që të merren masa të menjëhershme dhe të shqyrtohet në mënyrë kritike lista e debitorëve dhe arsyet pse ekziston kjo gjendje dhe të parandalohet vazhdimi i praktikave të tilla.			Nuk janë marrë masa.
	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se do merren masa të shpejta për vendosjen e mekanizmave dhe kontrolleve të duhura për t'i mbledhur borxhet e pa inkasuara si dhe të krijoj një bazë të saktë të dhënash për bizneset që operojnë në komunë.			Nuk janë marrë masa.
3.3 Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të inicoj një rishikim të gjendjes së obligimeve, për paraqitje të obligimeve bazuar në faturat e papaguara. Të gjitha faturat të protokolohen dhe që faturat e pa paguara të përcillen me kohë tek departamenti i financave në mënyrë që të procedohen për pagesë brenda afatit të paraparë.		Faturat protokolohen, mirëpo ende kemi vërejtje tek raportimi i obligimeve edhe pse shuma e mos raportimit nuk është e lartë.	

Shtojca III: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova



Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Podujevës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Kryetar i Komunës së Podujevës

Datë: 21. 05. 2018

Podujevë



Agim Veliu